



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Infermieristikës, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel akademik me kohë të plotë, i kategorisë asistent lektor.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të zotërojë diplomë universitare Ba dhe Master i Shkencave, ose ekuivalente me të, në fushën e shkencave mjekësore.
(Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njëhësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
2. Të ketë notë mesatare të studimeve Ba dhe Master i shkencave ose ekuivalente me të, mbi 8.
3. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna.
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
6. Të jetë i aftë për punë.

Kritere të veçanta.

1. Të jetë pjesëmarrës/e në aktivitete shkencore brenda e jashtë vendit në fushën e mjekësisë;
2. Të ketë mbi 2(dy) vite përvojë pune në IAL;
3. Të ketë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup;
4. Të ketë referenca nga punëdhënës të mëparshëm.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**04.09.2023 – 14.09.2023**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njëhësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kritereve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njëhësuar me origjinalin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetësore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (04.09.2023 – 14.09.2023) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyra”,
Aplikim për pozicionin e punës: *asistent lektor*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (18.09.2023 – 29.09.2023). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.